



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Shkurt 2026

MINISTRI I FINANCAVE PREZANTON DREJTORIN E RI TË DOGANAVE, BESMIR BEJA

Ministri i Financave, Petrit Malaj, prezantoi Drejtorin e ri të Përgjithshëm të Doganave, z. Besmir Beja, i cili merr detyrën duke zëvendësuar z. Gent Gazheli. Gjatë prezantimit, Ministri Malaj vlerësoi kontributin e z. Gazheli në drejtimin e Administratës Doganore, si dhe theksoi rëndësinë e vazhdimësisë institucionale dhe forcimit të mëtejshëm të rolit të Doganave në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit.

Drejtori i ri i Përgjithshëm, z. Beja, theksoi se prioritetet kryesore të punës së tij do të jenë rritja e angazhimit dhe përgjegjshmërisë së të gjitha strukturave doganore, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe avancimi i mëtejshëm i proceseve integruese, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira evropiane.

Administrata Doganore mbetet e angazhuar të vijojë reformat strukturore dhe procesin e modernizimit të shërbimeve, në funksion të integritetit evropian dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANËS SHQIPTARE PRET DREJTORIN E DOGANËS SË KOSOVËS
Drejtori i Përgjithshëm i Doganës Shqiptare, z. Besmir Beja, priti Drejtorin e Doganës së Kosovës, z. Agron Llugaliu, takim i cili shënoi edhe takimin e parë zyrtar të Drejtorit të Përgjithshëm që prej marrjes së detyrës.

Gjatë bashkëbisedimit, drejtuesit e dy institucioneve vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira dhe bashkëpunimin e konsoliduar ndër vite ndërmjet Doganës Shqiptare dhe asaj të Kosovës, duke theksuar se ky bashkëpunim ka qenë i qëndrueshëm, konstruktiv dhe në rritje të vazhdueshme, me rezultate konkrete dhe të matshme në disa sektorë të rëndësishëm për tregtinë dhe ekonominë e të dy vendeve.

Takimi rikonfirmoi angazhimin e përbashkët të Doganës Shqiptare dhe Doganës së Kosovës për të vijuar iniciativën të përbashkët që synojnë lehtësimin e tregtisë, rritjen e sigurisë dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik të dy vendeve.

TRAJNIM PËR KONTROLLIN E ANIJEVE TREGTARE ME ASISTENCËN E DOGANAVE FRANCEZE
Në Portin e Durrësit u krye trajnimi "Kontrolli i anijeve tregtare", i organizuar me asistencën e Doganave Franceze. Trajnimi u zhvillua në selinë e Komandës së Guardia di Finanza dhe synon rritjen e aftësive profesionale në fushën e kontrollit dhe inspektimit të anijeve tregtare, përmes një programi të kombinuar teorik dhe praktik.

Gjatë aktivitetit u theksua rëndësia e bashkëpunimit mes institucioneve shqiptare dhe partnereve ndërkombëtare për forcimin e kontrolleve detare dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira në këtë fushë. Trajnimi do të zgjasë pesë ditë dhe do të përfshijë sesione mbi strukturën e anijeve tregtare, standardet e sigurisë, menaxhimin e kontrolleve, si dhe ushtrime praktike në terren.



NIS ZYRTARISHT IMPLEMENTIMI I SISTEMIT DRITARJA E VETME KOMBËTARE

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u zhvillua takimi zyrtar hapës për fillimin e implementimit të Sistemit Dritarja e Vetme Kombëtare - National Single Window (NSW), në kuadër të Projektit "Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga një kredi e Bankës Botërore. Takimi u organizua në vijim të nënshkrimit të kontratës së implementimit për sistemin NSW nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, duke shënuar kështu nisjen formale të një prej reformave më të rëndësishme në drejtim të modernizimit dhe digjitalizimit të procedurave tregtare dhe doganore në vend.

Sistemi NSW synon modernizimin dhe unifikimin e procedurave të institucioneve shtetërore që operojnë në funksion të importeve, eksporteve dhe transitit, duke krijuar një platformë të vetme digjitale për shkëmbimin e dokumentacionit dhe të dhënave. Partnerë dhe përdorues të këtij sistemi janë 14 institucione dhe agjenci shtetërore, të cilat lëshojnë licenca, certifikata dhe autorizime në funksion të proceseve tregtare ndërkufitare.

BLLOKOHEN MBI 103 MIJË PALË VESHJE TË FALSIFIKUARA

Drejtorja e Antikontrabandës, në bashkëpunim me degën doganore Durrës, kanë goditur një rast të cënimit të pronësisë intelektuale. Janë konstatuar mbi 103 mijë palë veshje të ndryshme të markave Adidas, Nike, Gucci, Dior, Hugo Boss, Calvin Klein, etj, si edhe bluza të ndryshme sportive të ekipeve të njohura europiane.

Autoritetet doganore kanë bërë bllokimin e mallit dhe nisjen e procedurave përkatëse. Drejtorja e Përgjithshme e Doganave garanton se do të veprojë me tolerancë zero ndaj çdo subjekti që cënon pronësinë intelektuale dhe kryen shkelje të Kodit Doganor dhe legjislacionit në fuqi, duke vazhduar me kontrolle të imtësishme ndaj subjekteve me risk.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE: BASHKËPUNIMI ME BIZNESIN, THELBËSOR PËR NJË TREGTI TË NDERSHME DHE TË SIGURTË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një takim me përfaqësues të bizneseve që kanë aplikuar për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (AEO). Në fjalën e tij, drejtori Beja theksoi se,

Administrata Doganore është në shërbim të sipërmarrjes dhe vlerësoi aplikantët për statusin AEO, si ndër sipërmarrjet më të rregullta në vend dhe partnerë të vërtetë të doganës, duke theksuar se bashkëpunimi me biznesin është thelbësor për një tregti të ndershme dhe të sigurtë.

Gjatë takimit u fol për ecurinë e aplikimeve dhe për hapat e nevojshëm deri në miratimin e statusit. Drejtori Beja nënvizoi se synimi është që procesi të ecë me ritëm më të shpejtë, por pa cenuar standardet dhe verifikimet e nevojshme. Bizneset pjesëmarrëse shprehën vlerësime pozitive për bashkëpunimin me Administratën Doganore, duke e cilësuar si një partner dhe mbështetës, jo vetëm në aspektin procedural për përfitim të statusit AEO, por edhe në komunikimin dhe asistencën e vazhdueshme teknike.




ANTIKONTRABANDA BLLOKON MBI 3100 PAJISJE ELEKTRONIKE

Drejtorja e Antikontrabandës, në bashkëpunim me degën doganore Tiranë dhe Drejtorinë e Markave dhe Patentave, kanë bllokuar mbi 3100 pajisje elektronike të llojeve dhe markave të ndryshme, mbi dyshimin e falsifikimit/tregëtimit pa autorizimet parkatëse.

Organet doganore po vazhdojnë me kryerjen e të gjithë procedurave ligjore për verifikimin dhe hetimin e rastit, në vazhdimësi të angazhimit kundër hyrjes dhe tregëtimit në vendin tonë të produkteve të falsifikuara.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është në angazhim të plotë, me të gjitha strukturat e saj, për të bllokuar çdo tentativë abuzimi apo shkelje të ligjit. Drejtorja e Përgjithshme, siç ka dëshmuar në aksionet e fundit, garanton se do të veprojë me tolerancë zero ndaj çdo subjekti që kryen shkelje të Kodit Doganor.



BLLOKOHET SASI MIELLI JASHTË AFATEVE TË PËRDORIMIT

Dega e Doganës Durrës, gjatë kontrollit fizik në ambientet e një subjekti tregtar, i pajisur me autorizim për përdorimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv, ka bllokuar mallra që u kishte kaluar afati i përdorimit, referuar datës së skadencës.


Nga punonjësit e doganës është bllokuar sasia 2.500 kg miell orizi, me datë skadence 01.04.2025 dhe sasia 5.150 kg miell për pica, me datë skadence 07.04.2025. Dogana e Durrësit ka nisur procedurat, në bashkëpunim me strukturat e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në parashikim të kompetencave përkatëse, deri në asgjësimin e mallit.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave shpreh angazhimin maksimal për zbatimin e ligjshmërisë dhe nxit operatorët ekonomikë për respektimin e detyrimeve për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shtetasve.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE TËRHEQ VËMENDJEN MBI ZBATIMIN E REGJIMIT TË MAGAZINIMIT DOGANOR

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, nisur nga shqetësimet e ngritura nga strukturat e kontrollit dhe mbikëqyrjes, lidhur me zbatimin e procedurave që mundësojnë vendosjen/hyrjen e mallrave nën regjimin e posaçëm të Magazinimit Doganor, mbikëqyrjen e tyre dhe përmbylljen e regjimit (daljen e mallrave), ka kërkuar nga degët doganore dhe operatorët ekonomikë zbatimin në mënyrë sa më rigorozë të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë proces.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave shpreh bindjen se, zbatimi i ligjshmërisë dhe bashkëpunimi me operatorët ekonomikë do të garantojnë mbrojtjen e interesave ekonomikë dhe financiarë të vendit.





DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare



dogana.shqiptare



Dogana Shqiptare

Newsletter | Shkurt 2026



TAKIM ME STRUKTURAT E ANTIKONTRABANDËS: FORCIM LUFTËS KUNDËR PALIGJSHMËRISË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një takim me strukturat e Drejtorisë së Antikontrabandës, duke përcjellë një mesazh të qartë për forcimin e luftës kundër paligjshmërisë dhe duke falënderuar për aksionet e ditëve të fundit.

Në fokus të takimit ishte rritja e efikasitetit në parandalimin dhe zbulimin e shkeljeve doganore, si dhe shtimi i pranisë në të gjithë territorin e vendit. Drejtori Beja kërkoi më shumë vigjilencë dhe ndërgjegjësim të shtuar për rolin kyç që kjo drejtori ka në garantimin e një tregtie të ndershme dhe të sigurt.

Ai përgëzoi strukturën e Antikontrabandës për rezultatet konkrete të ditëve të fundit, ku brenda vetëm një jave u finalizuan me sukses tre operacione të rëndësishme kundër paligjshmërisë, duke e cilësuar këtë si një tregues të qartë të profesionalizmit dhe vendosmërisë në terren.

Drejtori Beja e cilësoi strukturën e Antikontrabandës si "rojtaren e ligjshmërisë" në Administratën Doganore, duke nënvizuar se lufta kundër kontrabandës mbetet një prioritet i panegociueshëm.

DREJTORI I DOGANAVE: MASA TË MENJËHERSHME PËR TË GARANTUAR VIJIMËSINË E LËVIZJES SË MALLRAVE PAS BLOKIMIT TË AKSIT LIBRAZHD-ELBASAN

Në konferencën e përbashkët për mediat, ku ishin të pranishëm drejtues të Autoritetit Rrugor Shqiptar, Hekurdhës Shqiptare, Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Policisë së Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, paraqiti masat e ndërmarra nga Dogana Shqiptare pas bllokimit të aksit Librazhd-Elbasan.

Në fjalën e tij, ai theksoi se situata është trajtuar me prioritet të menjëhershëm nga strukturat doganore.

Z. Beja bëri me dije se, për të shmangur pezullimin e lëvizjes së mallrave, janë orientuar alternativa përmes pikave kufitare Bllatë dhe Kakavijë, në varësi të origjinës së hyrjes së mallrave në territor. Në kuadër të koordinimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimit me autoritetet homologe, Drejtori i Përgjithshëm nënvizoi se është siguruar mirëkuptim i plotë nga pala e Maqedonisë së Veriut për lehtësimin e kalimeve në pikën e Bllatës.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE PRET EKIPIN E BANKËS BOTËRORE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, priti në një takim ekipin e Bankës Botërore, në kuadër të misionit përgatitor të projektit "Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project (TTFP) 2.0", një nismë rajonale që synon përmirësimin e lehtësimit të tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor.

Në fokus të takimit ishte modernizimi i shërbimeve doganore dhe përmirësimi i menaxhimit kufitar, me synimin për të përpunur praktikatat doganore shqiptare me standardet më të mira ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Europian. Drejtori Beja vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me Bankën Botërore dhe theksoi rëndësinë e fazës së dytë të projektit për avancimin e reformave në Administratën Doganore Shqiptare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE INSPEKTON DEGËN DOGANORE BLLATË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një inspektim në Degën Doganore Bllatë, në vijim të masave të ndërmarra për përballimin e situatës së krijuar nga bllokimi i aksit Librazhd-Elbasan dhe devijimi i fluksit të mjeteve drejt kësaj pike kalimi kufitar.

Pas marrëveshjes së arritur me palën maqedonase dhe koordinimit ndërinstitucional, kamionët që, për shkak të situatës rrugore, nuk mund të kalojnë përmes Degës Doganore Qafë-Thanë, po përdorin pikën e kalimit kufitar të Bllatës për hyrje/dalje në territorin doganor shqiptar. Kjo ka sjellë një rritje të menjëhershme të volumit të punës në këtë degë, duke kërkuar riorganizim të burimeve njerëzore dhe logjistike.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka angazhuar personel shtesë dhe ka marrë masa për garantimin e përpunimit sa më të shpejtë të formaliteteve doganore, me qëllim shmangien e vonësive dhe mbështetjen e operatorëve ekonomikë në këtë situatë të përkohshme.

FORCOHET BASHKËPUNIMI DOGANË-AKU PËR GARANTIMIN E SIGURISË USHQIMORE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Besmir Beja, zhvilloi një takim me Drejtoreshën e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Znj. Blerina Gjylameti, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjes së efikasitetit të kontroleve në pikat e kalimit kufitar.

Në fokus të diskutimeve ishte thellimi i koordinimit operacional ndërmjet strukturave të Doganës dhe inspektorëve të AKU-së, me synim konsolidimin e kontroleve të përbashkëta dhe rritjen e kapaciteteve parandaluese ndaj çdo rreziku që cenon sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik.

Të dy drejtuesit vlerësuan sigurinë ushqimore si një prioritet strategjik, duke theksuar se mbrojtja e konsumatorit dhe garantimi i standardeve të sigurisë në import mbeten objektiva parësore të bashkëpunimit ndërinstitucional. Në këtë kuadër, u dakordësua intensifikimi i mekanizmave të koordinimit dhe ngritja e praktikave të përbashkëta të kontrollit, veçanërisht në degët doganore kufitare.



PREZANTOHET KREU I RI DOGANËS SË TIRANËS



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Besmir Beja, prezantoi përpara stafit të administratës doganore të Tiranës, kryetarin e ri të kësaj degë, Erion Riçku, i cili merr detyrën në vijim të drejtimit trevjeçar të Ermal Shemës në një prej pikave më të rëndësishme të Administratës Doganore në vend. Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm falënderoi z. Shema për angazhimin dhe drejtimin e deritanishëm, duke vlerësuar kontributin dhe bashkëpunimin e tij gjatë kësaj periudhe. Duke prezantuar kreun e ri, z. Beja theksoi se Erjon Riçku vjen nga një eksperiencë e gjatë dhe e suksesshme në administratën shtetërore, çka përbën një vlerë të shtuar për drejtimin e Degës së Doganës Tiranë.



www.dogana.gov.al